



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Prokuroria Themelore Prishtinë / Osnovno Tužilaštvo Prishtina / Prishtina Basic

Prosecution

Autoriteti Kompetent / Kryeprokurori

AD.nr.13/2024

Datë: 05.09.2024

Autoriteti Kompetent, duke vendosur lidhur me ankesën disiplinore të pranuar përmes Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, të parashtruar nga ana e palës ankuese B.C, kundër E.R, Prokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, në bazë të nenit 9, paragrafi 1, pika 1.5 dhe paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me datë 05.09.2024 merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet ankesa disiplinore kundër E.R., Prokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, pasi që duke u bazuar në nenin 6, par. 2, pika 2.2, të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, veprimet e prokurorit nuk paraqesin shkelje disiplinore.

Arsyetim

Me datë 08.08.2024, Kryeprokurori, duke qenë në cilësinë e Autoritetit Kompetent, ka pranuar ankesën disiplinore përmes Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, të parashtruar nga ana e palës ankuese B.C., i cili ka cilësinë e palës së pandehur në lëndën penale PP/II.nr.... dhe PP/II.nr...., kundër prokurorit E.R., i cili ka qenë në trajtim të këtyre dy lëndëve penale, me pretendimet se prokurori i çështjes ka ngritur aktakuzë në lëndën PP/II.nr.... dhe PP/II.nr...., kundër tij edhe përkundër faktit se i njëjti është i pafajshëm, çka sipas tij në të dy lëndët është shpallë i pafajshëm nga gjykata e shkallës së parë vendim i cili është vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit si dhe pretendimet se nuk është ftuar as nga policia e as nga prokurori i çështjes për t'u deklaruar lidhur me këto dy çështje penale, e me të cilat veprime pretendohet se prokurori E.R ka rënë ndesh me Ligjin Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Autoriteti Kompetent, pas analizimit dhe trajtimit të detajuar të kësaj çështje, konsideron se pretendimet e ngritura ankimore nuk paraqesin bazë të mjaftueshme dhe të arsyeshme për të rekomanduar fillimin e procedurës disiplinore ndaj Prokurorit E.R.

Veprimet e Autoritetit Kompetent:

- Me datë 08.08.2024, Autoriteti Kompetent ka regjistruar ankesën disiplinore me numër AD.nr.13/2024.
- Me datë 12.08.2024, Autoriteti Kompetent ka njoftuar Kryesuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, përmes Letër Informimit, për pranimin dhe regjistrimin e ankesës.

Të gjeturat e Autoritetit Kompetent:

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me datën 03.11.2021 ka pranuar kallëzimin penal nga Policia e Kosovës, Stacioni Policor Jugu në Prishtinë, me numër të rastit, të datës 29.10.2021, kundër të dyshuarit B.C, me dyshimin se i njëjti ka kryer veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK-së). Pas shqyrtimit të kallëzimit penal nga ana e prokurorit E.R, me datë 08.11.2021 është lëshuar Urdhëresë drejtuar Departamentit të Mjekësisë Ligjore për dhënien e mendimit dhe konstatimit për të dëmtuarin H.G, lidhur me natyrën e lëndimeve trupore, mënyrën e shkakut të lëndimeve trupore, mjetin me të cilin janë shkakuar këto lëndime si dhe pasojat e shkakut të lëndimeve. Me datë 04.02.2022 është pranuar raporti i mjekësisë ligjore me nr.ref...., i dt.02.02.2022, ku sipas ekspertëve të mjekësisë ligjore nuk janë konstatuar dëmtime të dukshme të jashtme trupore për të dëmtuarin H.G. Pas shqyrtimit të kallëzimit penal dhe provave të bashkëngjitura, si dhe pas marrjes së raportit mjeko-ligjor, prokurori i çështjes me datë 13.04.2022 ka ngritur aktakuzën PP/II.nr...., kundër të pandehurit B.C, në drejtim të veprës penale Sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Për çështjen në fjalë me datë 26.06.2023 është mbajtur shqyrtimi fillestar e cila është shtyrë për shkak të mungesës së të pandehurit B.C, për të cilin gjykata me aktvendim kishte lëshuar urdhëresë për sjellje me detyrim.

Në lëndën tjetër penale, e evidentuar nën shenjë PP/II.nr...., të cilës i referohet pala ankuese B.C, Prokuroria Themelore në Prishtinë me datë 12.05.2023 ka pranuar kallëzimin penal nën numrin.... i dt.11.05.2023, kundër të dyshuarit B.C, me dyshimin se i njëjti kishte për të kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 i KPRK-së, ndërkaq me datë 18.05.2023 ka pranuar kallëzimin penal shtesë kundër të dyshuarit D.C dhe M.C në drejtim të veprës penale Sulm nga neni 184 i KPRK-së. Me datë 12.05.2023, prokurori i çështjes ka marrë Aktvendim për fillimin e hetimeve kundër të pandehurit B.C, me dyshimin e arsyeshëm se i njëjti ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 par.3 të KPRK-së. Me datë 22.05.2023 është lëshuar Urdhëresë për tërheqjen e video-incizimeve me qëllim të vërtetimit të rrethanave të rastit të datës 11.05.2023, lidhur me veprën penale të sulmit. Gjatë fazës hetimore, nga prokurori i çështjes me datë 12.05.2023 në cilësinë e të pandehurit është marrë në pyetje B.C, me datë 28.08.2023 në cilësinë e të pandehurit është marrë në pyetje M.C, po ashtu me po të njëjtën datë në cilësinë e të dëmtuarit-dëshmitarit është marrë në pyetje B.C, me datë 28.12.2023 në cilësinë e të dëmtuarit-dëshmitarit është marrë në pyetje Y.A dhe me datë 29.12.2023 në cilësinë e të dëmtuarit-dëshmitarit është marrë në pyetje A.H. Pas ndërmarrjes së këtyre veprimeve hetimore, me datë 26.01.2024 përmes Aktvendimit PP/II.nr...., prokurori i çështjes ka hudhur pjesërisht kallëzimin penal plotësues kundër të pandehurit D.C, për shkak se nuk ka ekzistuar dyshimi i arsyeshëm se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën është dyshuar, ndërkaq me datë 26.02.2024, pas vlerësimit të provave të mbledhura, e me krijimin e dyshimit të

bazuar mirë, është ngritur Aktakuza PP/II.nr., kundër të pandehurit B.C, me dyshimin e bazuar mirë se i njëjti ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 par.3 të KPRK-së si dhe ndaj të pandehurit M.C, në drejtim të veprës penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së. Në këtë çështje penale ende nuk është mbajtur shqyrtimi fillestar.

Duke analizuar rastin, po ashtu rrjedhën e veprimeve të ndërmarra nga Prokurori E.R, Autoriteti Kompetent vlerëson se veprimet e tij nuk përbëjnë shkelje disiplinore të cilat janë të parapara në mënyrë shprehimore me Ligjin Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Veprimet e ndërmarra pas hapjes së rastit

- Marrja e raportit me shkrim nga ana e prokurorit E.R lidhur me pretendimet ankimore.
- Shqyrtimi i shkresave të lëndës penale PP/II.nr... dhe PP/II.nr....

Deklarimet e palës ankuese

Me datë 05.08.2024, pala ankuese B.C pranë Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit ka parashtruar ankesën kundër prokurorit E.R, e cila me datë 08.08.2024 është përcjellë tek ne si Autoritet Kompetent për të trajtuar pretendimet nga kjo ankesë disiplinore. Në ankesën e tij disiplinore, pala ankuese pretendon se me datë 11.05.2023 është sulmuar nga tre persona për një reklamë ku është vërtetuar edhe nga video-incizimet që nuk është fajtor. I njëjti pretendon se është maltretuar nga policia për çka e ka njoftuar edhe IPK-në, ndërkaq prokurori i çështjes me fjalët e policisë e ka ndaluar për 48 orë. I njëjti pretendon se në këtë rast është shpallë i pafajshëm, ku ky vendim është vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit. I njëjti pretendon se edhe për rastin e kanosjes është shpallë i pafajshëm, ndërkaq prokurori E.R, i cili ka qenë prokuror i çështjes në të dy rastet PP/II.nr... dhe PP/II.nr..., ka ngritur aktakuzë ndaj tij edhe pse i njëjti është i pafajshëm. I njëjti pretendon se nuk është ftuar as nga policia e as nga prokuroria lidhur me këto çështje penale, ndërkaq pretendon se janë shkelur të drejtat e tij me ngritjen e aktakuzës nga prokurori çështje, duke cekur se prokurori E.R është pushuar një herë nga puna dhe është tmerr se çfarë prokuror ka ku nuk e din ku me ngrit aktakuzë por vetëm grumbullojnë lëndë.

Deklarimet e Prokurorit E.R. në raportin e tij me shkrim të dt. 21.08.2024

Prokurori E.R, në raportin e tij të dhënë me shkrim me datë 21.08.2024, ndër të tjera ka deklaruar se: *Lidhur me Pretendimet e palës B.C i cili në lëndën që e kam trajtuar unë si prokuror i rastit i njëjti ka pretenduar se unë kam bërë shkelje disiplinore të funksionit tim si Prokuror i Shtetit duke ngritur dy aktakuza dhe pretendimet e tij për pafajësinë në këtë shkresë drejtuar Prokurorit të Shtetit. Për këtë do të paraqes përmbledhje në pika të shkurta të veprime të mija si Prokuror i Shtetit:*

- *Lidhur me lëndën PP.II Nr...*

Me datën 11.05.2023 isha i caktuar Kujdestar në teren, dhe me këtë date nga Stacioni Policor në Graçanicë me është raportuar një rast të cilin pala B.C e ka paraqitur në stacion ku ka paraqitur rastin se është sulmuar nga disa persona pasi që sipas shkresave të lëndës i njëjti kishte një mosmarrëveshje me palët M.C dhe D.C, pasi jam njoftuar nga Policia për rastin kam urdhëruar

që të iniciohet rasti Sulm dhe të sigurohen provat për ta kompletuar rastin. Polica ka marr veprime dhe ka intervistuar të dyshuarit dhe dëshmitarin si dhe ka siguruar një video incizim. Në po të njëjtën ditë pas disa orësh Policia nga Stacioni Policor në Graçanicë ka njoftuar se personi B.C. gjatë qëndrimit në stacionin Policor e ka kanosur zyrtarin Policor Y.A., me fjalët **“edhe ti ki me pa personalisht çka ka me të gjet tash e tutje prej meje, kur dal nga ktu ki me pa krejt”** dhe duke e goditur tavolinën me dore ka kanosur se **“nëse ju nuk çelni rast ndaj auto sallonit dhe ati salduesit, mane në mend se B.C. ka me jav shk**** nënën krejtëve dhe sma nin për kërkon, as për prokuror as për kërkon tjetër”**, pas kësaj kam marr raportet zyrtare të policëve kam iniciuar rast ndaj të dyshuarit B.C. për vepër penale Kanosje nga neni 181 paragrafi 3, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe kam lëshuar Aktvendim për ndalim 48 orësh. Me datën 12.05.2023 kam marr aktvendim për fillim të hetimeve dhe po ashtu është sjell i dyshuari nga Policia në zyre time dhe pas kësaj kam lëshuar Urdhëresë për lirim në procedurë të rregullt. Gjatë fazës së hetimeve kam marr veprime hetimore duke intervistuar të dyshuarit dhe dëshmitarët si dhe me urdhëresë kam kërkuar tërheqjen video incizimet. Gjatë procesit hetimore në mungesë të provave kam bërë pushim të pjesshëm të hetimeve ku me asnjë prove nuk është vërtetuar se i pandehuri D.C. ka kryer veprën penale për të cilën është dyshuar, ndërsa ka vazhduar procedura penale ndaj të pandehurit M.C. për vepër penale Sulmi nga neni 184 i KPRK-së. Pas përfundimit të procedurës hetimore me datë 26.02.2024 kam ngrit aktakuze kundër M.C. për vepër penale Sulmi nga neni 184 par.1 i KPRK- se ku pale e dëmtuar është pala ankuese B.C. Në piken 2 të dispozitivit të kësaj aktakuze kam akuzuar të pandehurin B.C. për vepër penale Kanosje nga neni 181 par.3 te KPRK –së, ku pale e dëmtuar është zyrtari Policor Y.A. Aktakuza është dorëzuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë – dega në Graçanicë me datën 26.02.2024 dhe nuk kam njoftime nëse është zhvilluar procesi gjyqësor. Aktakuza është e bazuar në ligj dhe e mbështetur me prova të mjaftueshme.

- Lidhur me lëndën PP.II.nr...

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me datë 03.11.2021 nga Stacioni Policor Jugu në Prishtinë, ka pranuar kallëzimin penal me numër të rastit ..., kundër të pandehurit B.C. për shkak të dyshimit të arsyeshëm se ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor. Lëndën PP.II.nr... e kam pranuar në procedurë të rregullt dhe pas kësaj Urdhëresën e kam dërguar në Institutin e mjekësisë ligjore për konstatimin e lëndimeve trupore për palën e dëmtuar në këtë rast H.G. Sipas shkresave të lëndës, deklaratën e të pandehurit në këtë rast i njëjti ditën kritike kishte shkuar në Inspektoratin Shëndetësor për të raportuar një rast të korrupsionit por se aty kishte pasur mosmarrëveshje me zyrtarët e Inspektoratit Shëndetësor. Sipas kallëzimit penal i cili është mbështetur në deklaratën e të dëmtuarit dhe deklaratat e dëshmitareve si dhe vet deklarata e të pandehurit e dhënë në hetuesi në polici, gjendja faktike është paraqitur si ne vijim: **Me datën 25.10.2021, rreth orës 11:00 në objektin e Inspektoratit Shëndetësor të Ministrisë së Shëndetësisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, i pandehuri B.C., pas një fjalosje të atë çastshëm, me dashje ka përdor forcën fizike duke e sulmuar fizikisht të dëmtuarin zyrtarin H.G. e ka shtyre dhe përplasur për dollapi në zyrën e tij dhe pastaj i pandehuri është larguar nga objekti i Inspektoratit Shëndetësorë.**

Duke marr parasysh që për ketë vepër mund të ngritet aktakuze e drejtpërdrejt, si prokuror i rastit kam konsideruar se ka prova të mjaftueshme për të ngritur aktakuzën. Policia e Kosovës ka intervistuar të dëmtuarin dhe 3 dëshmitar, të cilat të gjitha janë të bashkangjitura në shkresat e lëndës së bashku me aktin akuzues dhe të cilët e vërtetojnë gjendjen faktike si në aktakuzë. Nuk qëndron pretendimi i palës ankuese në këtë rast se nuk është marr në pyetje as në polici e as në prokurori pasi që siç munde të shihni në shkresat e lëndës që ju bashkëngjisë në këtë rast i njëjti

është intervistuar në polici me datën 28.10.2021 ora 10.50, Stacion Policor Jugu në Prishtinë. Me datën 13.04.2022 kam ngritur Aktakuzën duke u bazuar në provat që gjendeshin në shkresat e lëndës. Me datën 31.07.2023 është caktuar seanca fillestare në lenden PP.II.nr.... nga Gjyqtarja N.K.J, ku në këtë seancë ka marr pjesë Prokurorja E.B.K. pasi që unë si prokuror i rastit isha në pushim vjetor, në këtë seancë i pandehuri ka bërë ofendime ndaj meje si prokuror i rastit dhe ndaj të gjithë prokurorëve (shih te bashkangjitur email-in e dërguar nga Prokurorja). Unë si Prokuror i çështjes kam analizuar dhe vlerësuar në mënyrë të paanshme dhe objektive, çdo prove një nga një secilën veç e veç, në lidhje me njëra tjetrën dhe në fund të gjitha së bashku, në të dy rastet dhe kam ngritur aktakuzën. Prandaj, unë detyrën dhe përgjegjësitë e mia i kam përfunduar në pajtim me Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin e Etikës së Prokurorit, për çka nuk konsideroj se nuk kam bërë ndonjë shkelje e cila do të paraqitej si shkelje disiplinore nga ana ime, rastet janë në procedurë në gjykatë dhe se gjykata do të vendos për fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit në këto dy raste.

Konsideroj së në dy rastet PP.II Nr....dhe, unë si Prokuror nuk kam bërë asnjë shkelje të pretenduar sipas kësaj ankuese, për çka ju lus që Ju i nderuar Kryeprokuror ankesën e ushtruar kundër meje ta HUDHNI si të pabazuar.

KONKLUDIM

Në cilësinë e Autoritetit Kompetent, konsiderojmë se veprimet e prokurorit E.R. gjatë trajtimit të lëndëve penale PP.II.Nr..... dhe PP.II.Nr.... kanë qenë në kuadër të autorizimeve të tij ligjore dhe kushtetuese. Kodi nr. 08/l-032 i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës (tutje KPRK), neni 234, paragrafi 1 ka paraparë se “Pas përfundimit të hetimit ose kur prokurori i shtetit konsideron se informacionet me të cilat ai disponon për veprën penale dhe kryerësin e saj paraqesin dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale apo vepra penale, procedura para gjykatës mund të zbatohet vetëm në bazë të aktakuzës së ngritur nga prokurori i shtetit”. Në rastet e lartcekura, prokurori E.R. kundër së cilit është paraqitur kjo ankesë disiplinore, ka vlerësuar se në këto dy çështje penale ndaj të pandehurit B.C., në çështjen penale nën shenjë PP/II.nr...., ekziston dyshimi i bazuar mirë se i njëjti ka kryer veprën penale Sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402 paragrafi 1 i KPRK-së, si dhe në çështjen penale të evidentuar nën numrin PP/II.nr.... ekziston dyshimi i bazuar mirë se i lartcekuri ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 3 i KPRK-së. Se i pandehuri, këtu pala ankuese B.C. e ka kryer veprën penale Sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402 paragrafi 1 i KPRK-së, vërtetohet nga deklaratat e të dëmtuarit H.G., deklaratat e dëshmitares N.K-D., deklaratat e dëshmitares A.Z-C., deklaratat e dëshmitares E.Sh-K., në bazë të së cilave prova personale vërtetohet se i pandehuri B.C. me datë 25.10.2021, kishte përdorë forcë duke e sulmuar fizikisht zyrtarin e Ministrisë së Shëndetësisë, të dëmtuarin H.G., duke e shtyrë dhe përplasur për dollapin e zyrës së tij. Prokurori i çështjes duke i çmuar këto prova dhe duke i lidhur në kontekstin logjik dhe faktik me njëra-tjetrën ka ardhur në përfundim se në rastin konkret në veprimet e të pandehurit qëndrojnë të gjitha tiparet e veprës penale nga neni 402 par.1 i KPRK-së, andaj me datë 13.04.2022 ka ngritur aktakuzë të drejtpërdrejtë kundër të pandehurit B.C. Nuk qëndron pretendimi i palës ankuese se nuk është marrë në pyetje në polici, meqë nga shkresat e lëndës vërtetohet se i njëjti është marrë në pyetje me datë 28.10.2021 në Stacionin Policor Jugu, ndërkaq në faqen e fundit të procesverbalit i njëjti ka vënë edhe nënshkrimin e tij. Nuk qëndron as pretendimi tjetër i palës ankuese, se i njëjti është shpallë i pafajshëm nga gjykata e shkallës së parë dhe ky vendim është vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit, meqë kjo çështje penale ende nuk ka marrë epilog në gjykatën e shkallës së parë, rrjedhimisht çështja është ende në fazën e shqyrtimit gjyqësor. Sa i përket ngritjes së aktakuzës nga prokurori i çështjes, i njëjti ka vepruar konform dispozitave të

Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (Nr.04/L-123), ku pas vlerësimit të të gjitha provave të bashkëngjitura kallëzimit penal, me datë 13.04.2022 ka ngritur aktakuzë të drejtpërdrejt kundër të pandehurit B.C., me dyshimin e bazuar mirë se i njëjti ka kryer veprën penale Sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402, paragrafi 1 i KPRK-së. Në rastin konkret, veprimet e prokurorit E.R. kanë qenë karshi autorizimeve dhe përgjegjësisë të tij ligjore dhe kushtetuese si Prokuror i Shtetit.

Sa i përket lëndës penale të evidentuar nën shenjë PP/II.nr..., ku pala ankuese pretendon se ka qenë i sulmuar dhe është i pafajshëm, prokurori i çështjes me datë 26.02.2024 ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit M.C. me dyshimin e arsyeshëm se i njëjti me datë 11.05.2023, ka përdorë forcë fizike ndaj të dëmtuarit, këtu palës ankuese B.C., ku i njëjti e kishte goditur të dëmtuarin me shqelm në krahun e majtë, andaj pretendimi i palës ankuese se ditën kritike ka qenë i sulmuar qëndron, përveç pjesës ku deklaroi se ka qenë i sulmuar nga tre persona, meqë nga video-incizimet e siguruar në fazën hetimore vërtetohet se sulmi është kryer vetëm nga i pandehuri M.C., ndaj të cilit edhe rëndon Aktakuza PP/II.nr... e dt.26.02.2024. Pretendimet e palës ankuese se kundër tij është ngritur aktakuzë nga prokurori E.R. edhe pse i njëjti është i pafajshëm, ku sipas pretendimeve të tij, pafajësia e tij vërtetohet nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe shkallës së dytë, as ky pretendim nuk qëndron për faktin se përgjegjësia penale e të pandehurit B.C. vërtetohet nga deklarata e të dëmtuarit, zyrtarit policor Y.A. dhe dëshmitarit, zyrtarit policor A.H., ku të njëjtit pranë prokurorit të çështjes kanë deklaruar se ditën kritike, respektivisht me dt. 11.05.2023, në Stacionin Policor në Graçanicë, gjersa personi B.C. kishte shkuar për të raportuar rastin e sulmit ndaj tij, i njëjti e ka kanosur zyrtarin policor, të dëmtuarin Y.A. me fjalët *“edhe ti ki me pa personalisht çka ka me të gjete tash e tutje prej meje, kur dal nga ktu ki me pa krejt”*, duke e goditur tavolinën me dorë dhe duke vazhduar me fjalë kanosëse *“nëse ju nuk qelni rast ndaj autosallonit dhe atij salduesit, mane në mend se B.C. ka me jau shk**** nanën krejtve dhe sma nin për kërkon, as për prokuror as për kërkon tjetër”*, me çka të dëmtuarit-zyrtarit policor Y.A. i kishte shkaktuar ndjenjën e frikës dhe pasigurisë për jetë. Prokurori i çështjes duke vlerësuar provat materiale dhe personale në këtë çështje penale, e me dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri B.C. ka kryer veprën penale, me datë 26.02.2024 ka ngritur Aktakuzë pas hetimeve ndaj të pandehurit B.C. në drejtim të veprës penale Kanosja, nga neni 181, paragrafi 3 i KPRK-së. Pretendimet e ankuesit B.C. se gjykata ka vendosur për pafajësinë e tij nuk qëndrojnë, meqenëse aktakuza edhe pse e ngritur me datë 26.02.2024 nga ana e prokurorit E.R., ende nuk është konfirmuar nga gjykata dhe ende nuk është mbajtur shqyrtimi gjyqësor, andaj rrjedhimisht ende nuk ka vendim të formës së prerë të gjykatës lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit B.C.

Pretendimet ankimore të B.C. se i njëjti është maltretuar nga policia për çka ka lajmëruar rastin në Inspektoratin Policor të Kosovës (tutje IPK), konsiderojmë se meqë ankuesi deklaroi se rasti është lajmëruar në IPK, nuk është në kompetencën tonë si Autoritet Kompetent të përfshihemi në çështjen e tillë, ndërkaq mbi të gjeturat e IPK-së, nëse veç ka dyshim të arsyeshëm për kryerjen e ndonjë veprë penale nga ana e zyrtarëve policorë, është në përgjegjësinë e tyre që rastet e tilla t'i sjellin në Prokurorinë kompetente për hetim të mëtejshëm.

Deklarimet e palës ankuese se *“tmerr çfarë prokurorë ka, kur nuk dijnë me ngrit aktakuzë por vetëm t'i grumbullojnë lëndët sa më shumë”*, theksojmë se Këshilli Prokurorial i Kosovës ka mekanizma për vlerësimin e performancës së prokurorëve në baza periodike, andaj çështja e profesionalizmit dhe efikasitetit të prokurorëve nuk është kompetencë e vlerësimit të personave fizik apo juridik, ndërkaq ne si Autoritet Kompetent në deklaratimet e tilla të palës ankuese as nuk do të lëshohemi, meqë të njëjtat nuk kanë asnjë relevancë lidhur me këtë çështje disiplinore.

Deklarimet e palës ankuese se i janë shkelur të drejtat e njeriut nuk qëndrojnë, kjo për faktin se lidhur me të drejtat e tij i njëjti ka qenë i njoftuar, qoftë nga policia ashtu edhe nga prokuroria me rastin e dhënies së deklaratave për dy rastet e lartpërmendura dhe në asnjë moment, asnjë e drejtë e tij si i pandehur në procedurë penale nuk është evidentuar të jetë shkelur.


Në kontekst të veprimeve të lartpërmendura, si Autoritet Kompetent, vlerësoj se nuk është provuar se Prokurori E.R. është përfshirë në veprime të cilat do të binin ndesh me dispozitat e Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Nga krejt çka u konstatuar më lartë, kemi gjetur se nuk qëndrojnë pretendimet e deklaruara në këtë ankesë disiplinore, ngase në asnjë rast NUK është vërtetuar se veprimet e prokurorit paraqesin shkelje disiplinore në bazë të nenit 6, par. 2 pika 2.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ankesën disiplinore e REFUZOJMË SI TË PABAZUAR.

Me sa u cek më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

AUTORITETI KOMPETENT - KRYEPROKURORI



Zejnullah Gashi

Vendimi i dërgohet:

- **Këshillit Prokurorial të Kosovës**
- **Arkivës**